

Mirë se vini në qendrën e mbërritjes



Fletëpalosja u shpërndahet personave që kërkojnë azil në qendrën e mbërritjes së Fedasil në Bruksel



Dita juaj e parë në qendrën e mbërritjes

Ju do të ndiqni hapa të ndryshëm brenda qendrës.



Info
Fedasil

01 / Pritja

Nëse shpjegoni se doni të bëni kërkesë për “mbrojtje ndërkombëtare” (të bëni kërkesë për azil në Belgjikë), do t’ju kërkohet të hyni në qendër për të paraqitur kërkesën tuaj.

Bagazhet tuaja: stafi i qendrës do t’jua marrë bagazhet dhe do t’i ekzaminojë ato. Bagazhet tuaja do t’i merrni më vonë atë ditë. **Mbajini me vete sendet tuaja me vlerë dhe dokumentet e identitetit (mos i lini në bagazhe)**. Këto dokumente do të jenë të dobishme për të paraqitur kërkesën tuaj.



02 / Regjistrimi

Këtu, Zyra e Emigracionit do të regjistrojë kërkesën tuaj për mbrojtje ndërkombëtare.

Një oficer nga Zyra e Emigracionit do t’ju drejtojë disa pyetje për të përcaktuar identitetin tuaj (emrin, datën e lindjes, kombësinë etj.). Ai do t’ju kërkojë dokumentet e identitetit që keni me vete.

Oficeri nga Zyra e Emigracionit gjithashtu do t’ju marrë gjurmët e gishtave. Kjo i lejon Zyrës së Emigracionit të kontrollojë nëse jeni regjistruar tashmë në një vend tjetër të Evropës. Nëse jeni, mund të dërgoheni sërish te ky vend për ta bërë atje kërkesën për mbrojtje ndërkombëtare.



03 / Kontrolli mjekësor

Ekipi mjekësor i Fedasil do të kontrollojë nëse jeni në gjendje të mirë shëndetësore. Të gjithë i nënshtrohen kontrollit mjekësor. Ju mund të bëni vakcina kundër sëmundjeve ngjitëse, në varësi të vendit tuaj të origjinës. Infermieri do të shkruajë një raport mjekësor.

Do të na duhet gjithashtu të bëjmë një grafi të mushkërive tuaja për të parë nëse keni tuberkuloz. Kjo është sëmundje shumë ngjitëse dhe mund të na duhet t’ju çojmë në spital nëse jeni i sëmurë.



04/ Akomodimi

Këtu, do të gjeni bagazhet tuaja. Një punonjës i Fedasil do të kontrollojë nëse keni të drejtën për strehim ndërkohë që shqyrtohet kërkesa juaj për mbrojtje ndërkombëtare.



[A keni të drejtën për strehim?](#) Ju do të qëndroni përkohësisht në qendrën e mbërritjes. Më pas do të transferoheni në një qendër tjetër ku do të qëndroni gjatë përpunimit të procedurës suaj të azilit. Fedasil do t'ju ofrojë një vend strehimi: shpesh ky vend është një qendër e menaxhuar nga Fedasil ose Kryqi i Kuq. Është një qendër "e hapur", që do të thotë se mund të hyni dhe të dilni lirshëm nga kjo ndërtesë me kusht që të respektoni rregullat e qendrës. Fedasil do ta zgjedhë qendrën sipas shtretërve të disponueshëm në qendra në atë kohë, dhe duke marrë në konsideratë situatën tuaj (përbërjen familjare, shëndetin tuaj etj.). Strehimi është një e drejtë, por jo detyrim; ju gjithashtu mund të refuzoni qendrën që Fedasil ju ofron, për shembull nëse keni miq në Belgjikë që mund t'ju ofrojnë akomodim.



[Nuk keni të drejtën për strehim?](#) Ju duhet të largoheni nga qendra e mbërritjes. Ne do t'ju shpjegojmë se keni të drejtën për asistencë urgjente mjekësore, por nuk mund të shkoni në një vend strehimi.

Çfarë është?

Gjeni kuptimin e fjalëve të vështira në këtë fletëpalosje.

[Kërkesa për mbrojtje në Belgjikë?](#) Nëse jeni larguar nga vendi juaj dhe keni bërë kërkesë për azil në Belgjikë, ju mund të paraqisni një kërkesë për "mbrojtje ndërkombëtare".

[Qendra e mbërritjes?](#) Në këtë ndërtesë në Bruksel ("Petit-Château") mund t'ua paraqisni autoriteteve belge kërkesën tuaj për mbrojtje ndërkombëtare. Juve mund t'ju ofrohet akomodim ndërkohë që shqyrtohet kërkesa juaj, në varësi të situatës suaj.

Qendra e mbërritjes menaxhohet nga Fedasil, që është një organizatë qeveritare. Kërkesa juaj për mbrojtje ndërkombëtare do të regjistrohet në qendër nga një organizatë tjetër qeveritare: [Zyra e Emigracionit](#).

Kontakti me Drejtorin e Pajtueshmërisë të

Qendra e mbërritjes

Hapur nga e hëna në të premte


- Regjistrimi i kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare (kërkoni azil): regjistrimi në orën 8.30 të mëngjesit.
- Kërkoni informacion në Pikën e Informacionit: hapur nga ora 8.30 e mëngjesit deri në orën 12.30 të drekës.

Adresa:

Rruga 'Rue de Passchendaele 2'
1000 Brussels

Telefon +32 (0)2 793 82 40

Email: dispatching@fedasil.be



Sporteli i kthimit vullnetar

Fedasil mund t'ju ndihmojë nëse po mendoni të ktheheni në vendin tuaj të origjinës. Ju mund të drejtoni pyetje në "sportelin e kthimit" të Fedasil.

Rue d'Arenberg, 8 – 1000 Brussels

Telefon 0800/327 45 (numër falas) ose 02/897 53 00

Hapur nga e hëna në të premte nga ora 9:30 deri në 12:00 ose duke lënë takim.

MË SKANO



Më shumë informacion? www.fedasilinfo.be

Kjo dosje është e disponueshme në 14 gjuhë | Produksioni: Fedasil

Redaktori: Michael Kegels | Përditësim: 04.2021